

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1035 Prot.

Tiranë, më 02.08 2017

VENDIM Nr. 151, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Terminalit për Depozitat JET A1" pranë Aeroportit "Nënë Tereza"*-subjekti "A&V Gas" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Terminalit për Depozitat JET A1" pranë Aeroportit "Nënë Tereza"*-subjekti "A&V Gas" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Subjekti "A&V Gas" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për projektin *"Ndërtimi i Terminalit për Depozitat JET A1" pranë Aeroportit "Nënë Tereza"*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI KKA
RUDINA ZOPO

